

INFORMATÄ PËR PRINDËR
ANESTEZIONI

... rreth e përqark operacionit



Fëmija Juaj së shpejti do të operohet tek ne në spitalin e fëmijëve. Ju me siguri jeni kujtuar deri me tani se si do të rrjedhë Anestezioni (Narkoza) dhe operacioni, dhe si mundeni Ju të e përgatisni fëmijën Tuaj për këtë dhe si mundeni të e mbështesni me atë rast. Kjo broshurë ju paraqet Juve një rrjedhë të mundshme, gjatë dhe pas operacionit.

Ne ju dëshirojmë Juve dhe fëmijës Tuaj një qëndrim të këndshëm në spitalin e fëmijëve!

Para pranimit në spital

Me një letër Ju do të informoheni mbi datën e pranimit, datën e operimit dhe mbi dokumentacionin, i cili i nevojitet spitalit prej Juve (p.sh. kartelat e sigurimit).

Para operacionit

Para operacionit bëhen bisedat me mjeken e stacionit, me gruan kujdestare dhe me anestezistin. Anestezisti është përgjegjës për narkozë.

Disa persona të specializuar punojnë bashkërisht për të mirën e fëmijës Tuaj. Për këtë arsye është e mundur, që Juve prej anëve të ndryshme të ju shtrohen me përsëritje pyetjet e njëjta. Merreni këtë Ju lutemi si faktor sigurie.

Biseda me anestezistin, e ashtuquajtura vizitë e para medikamentimit, bëhet me rast të një qëndrimi disa ditore në spital në ditën (ditën më parë) të operimit.

Me rast të një intervenimi ambulant



kjo bisedë bëhet me ditë deri me javë më parë në një orë bisede me anestezistin.

Anestezisti informohet mbi gjendjen aktuale shëndetësore dhe historinë e sëmundjes së fëmijës Tuaj. Ai e diskuton me Ju dhe me fëmijën Tuaj rrjedhën e narkozës si dhe teknikën e planifikuar të narkozës. Më tutje ai ju sqaron Juve mundësitë e rrezikut dhe veprimeve anësore të narkozës dhe ju informon mbi terapinë kundër dhimbjeve pas operacionit. Ai ju tregon Juve, se sa gjatë para operacionit fëmija Juaj mundet të han gjegj. të pinë dhe se a do të merr ndonjë mjet qetësimi para operacionit. Ju do të informoheni mbi

kujdesin e fëmijës Tuaj pas operacionit dhe mbi atë se kur mundeni të e shihni atë prapë. Fëmija Juaj para pranimit në spital do të duhej të ishte larë në vaskë apo të ketë bërë një dush. Përveç kësaj sillni edhe disa gjëra personale me vete, si kukulla, eventualisht gjëra speciale ushqimore apo medikamentet e veta. Më tepër informata mbi këtë, së bashku me listën e paketimeve, Ju gjeni në informacione për prindër: «Shtrirja në spital».

Në mënyrë që fëmija Juaj në ditën e operimit të ketë vëmendjen Tuaj të plotë, ne ju lusim të mos merrni me vete motra dhe vëllezër apo vizitorë.

Në ditën e operacionit

Varësisht nga vendimi apo nga marrëveshja fëmija Juaj ca kohë para anezionit merr një mjet qetësimi në formë të një tablete, të një supozitori apo si shurup.

Përcjellja në sallë operimi

Sipas marrëveshjes me anezististin përcjellja e njërit nga prindërit deri në paradhomë të sallës së operimit deri me rast të rënies në gjumë të fëmijës Tuaj është i mundur.

Fillimi i narkozës

Fëmija Juaj bie në gjumë në dhomën e përgatitjes së narkozës. Kjo ndodhë ose përmes thithjes së gazit narkotik përmes një maske, apo në atë mënyrë që i injektohet një

mjet për vënie në gjumë. Shpesh infuzioni për dhënie të lëngjeve dhe mjeteve kundër dhimbjes i vendoset së pari në gjumë. Menjëherë pas kësaj Ju do të shoqëroheni nga gruaja kujdestare për në stacion kujdestarie. Ngarkesa psikike për Ju si prind me rast të fillimit të anezisë dhe me rast të përshëndetjes Tuaj nga fëmija duke rënë në gjumë nuk mund të nënçmohet. Për këtë arsye mendohuni më parë, se a doni të e përcillni fëmijën Tuaj deri në sallë operimi apo të përshëndeteni me të më parë. Bisedoni për këtë me gruan kujdestare apo me anezististin.



Tani fillon koha e pritjes, të cilën Ju mund të organizoni individualisht. Spitali i fëmijëve ka përpiluar një broshurë informimi për kalimin e kohës së pritjes. Drejtohuni tek grua kujdestare, nëse keni pyetje tjera.

Pas operacionit

Gjatë fazës së zgjimit nga anestezioni, Ju dhe fëmija Juaj në stacionin për zgjim do të keni mbikëqyreni nga një grua kujdestare. Gjatë kësaj kohe do të kontrollohen rregullisht sistemi i qarkullimit të gjakut, frymëmarrja dhe vetëdija. Kohë pas kohe paraqiten

shqetësime, ngjirje e zërit, dhimbje apo të përziera. Prania Juaj vepron si qetësim mbi fëmijën Tuaj. Gjithashtu gjërat personale dhe të njohura i japin fëmijës Tuaj siguri dhe mrojtje.





Sërish i zgjuar

Pas fazës së zgjimit dhe mbikëqyrjes së shpeshtë fëmija Juaj do të transferohet prapa në stacionin për kujdes. Gruaja kujdestare është personi kontaktues dhe ajo do ju informon mbi veprimet e mëtutjeshme.

Rrjedha e përshkruar në raste të veçanta mund të ndryshon. Po që se kjo do të ishte rast me fëmijën Tuaj, ne do të mundohemi, të ju informojmë me kohë. Ne jemi të obliguar, që rastet urgjente të i trajtojmë menjëherë. Për këtë arsye kohë pas kohe mund të vjen deri te pritja dhe shtyrja e operimeve të planifikuara. Ne Ju lusim për mirëkuptim.